



18/3/22
23/03/22

4
K. Qemali



MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

E nënshkruar me datë 23/03/2022 ndërmjet:

Shoqatës së Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës (SHKÇAK), me adresë në Rr. Sylejman Vokshi nr.50, Prishtinë, Republika e Kosovës, përfaqësuar nga Znj. Shpresa Mustafa, Kryetare e Bordit, (në vijim SHKÇAK)

dhe

Bordi i Mbikëqyrjes Publike Shqipëri (BMP), me adresë në Rruga "Ismail Qemali" Ndërtesa nr. 22, Hyrja 4, Apartamenti nr. 24, Kati i 5-të, Tiranë, Republika e Shqipërisë, përfaqësuar nga Z. Dritan Fino, Kryetar (në vijim BMP)

SHKÇAK është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e themeluar në vitin 2001 me qëllim të zbatimit dhe promovimit të standardeve ndërkombëtare dhe praktikave më të mira për profesionin e kontabilitetit dhe auditimit si dhe asistimit në zhvillimin ekonomik në të mirë të interesit publik.

Si organizatë e parë profesionale e kontabilitetit dhe auditimit në Kosovë, SHKÇAK përfaqëson më shumë se 8000 profesionistë të cilët janë angazhuar në sektorë të ndryshëm dhe institucione kyçe të Republikës së Kosovës, si Zyra e Kryeministrit, Ministritë, Banka Qendrore, Zyra Kombëtare e Auditimit, Dogana e Kosovës, Administrata Tatimore e Kosovës, Komunitat si dhe bizneset dhe firmat e auditimit.

SHKÇAK është e vetmja organizatë në Kosovë që është anëtare e Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve (FNK), Federatës Evropiane të Kontabilistëve dhe Auditorëve për NVM (EFAA), Federatës Mesdhetare të Kontabilistëve (FCM), pjesë e Grupeve të Ekspertëve për Kontabilitet dhe Auditim të EFAA-së. SHKÇAK përfaqëson zërin e profesionistëve të Kosovës në këto organizata globale standard-vënëse dhe luan rol aktiv në zhvillimet globale të profesionit.

BMP është një institucion me statusin e një autoriteti rregullator të pavarur, i cili vepron në bazë dhe për zbatim të Ligjit Nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar" i ndryshuar. Misioni i Bordit të

Mbikëqyrjes Publike është mbikëqyrja publike e audituesve ligjorë dhe shoqërive të auditimit, organizatave profesionale të audituesve ligjorë si dhe organizatave profesionale të kontabilistëve të miratuar me qëllim përmbushjen e objektivave publike në mbështetje dhe në zbatim të ligjit, akteve nënligjore, kuadrit rregullator dhe në shërbim të interesit publik. Gjithashtu, objektivi kryesor i BMP-së është të rrisë sigurinë që auditimet ligjore kryhen në një mjedis transparent, të kontrolluar dhe të kujdesshëm e në shërbim të interesit publik. Në ushtrimin e funksionit rregullator dhe mbikëqyrës, BMP udhëhiqet nga parimet dhe normat e pavarësisë, transparencës dhe integritetit.

QËLLIMI

1. Të dyja palët synojnë të përmirësojnë cilësinë, saktësinë dhe besueshmërinë e profesionit të auditimit nëpërmjet rregullimit të auditimit dhe mbikëqyrjes së auditimit, në mënyrë që të mbrojnë investitorët, të ndihmojnë në forcimin e besimit të publikut në auditim dhe të rrisin besimin e investitorëve në tregjet e tyre përkatëse të kapitalit;
2. Të dyja palët pranojnë se është në interesin e tyre të përbashkët të bashkëpunojnë në shkëmbimin e përvojave të tyre në lidhje me zhvillimin e profesionit të auditimit, në masën që një bashkëpunim i tillë është në përputhje me ligjet përkatëse;
3. Qëllimi i këtij Memorandumi është të përshpejtojë përputhshmërinë me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit dhe standardet e tjera ndërkombëtare, dispozitat e kornizës, deklaratat praktike dhe Kodin e Etikës të nxjerrë nga IFAC dhe të lehtësojë bashkëpunimin e ndërsjellë ndërmjet Palëve, në masën e lejuar nga ligjet e tyre kombëtare përkatëse, në fushën e auditimit.
4. Ky memorandum nuk krijon asnjë detyrim ligjor dhe nuk zëvendëson asnjë ligj apo akti nënligjor.

OBJEKTIVAT

Ky memorandum ka për qëllim krijimin e një bashkëpunimi ndërmjet SHKÇAK dhe BMP me qëllim të koordinimit të përpjekjeve të tyre:

- Për të punuar në bashkëpunim në mënyrë që të zhvillojnë një udhërrëfyes për arritjen e një partneriteti afatgjatë në lidhje me profesionin e auditimit, trajnimin, dhe shërbimet e lidhura në Republikën e Kosovës dhe Republikën e Shqipërisë;
- Që secila palë të angazhohet në organizimin për shkëmbimin e kapaciteteve teknike profesionale ndërmjet tyre, për të lehtësuar ndarjen e ekspertizës dhe përvojave lidhur me zhvillimet në profesion;

- Që secila palë të ndajë me tjetrën informacionet e duhura teknike, edukimit profesional, të trajnimit dhe informacione të tjera si bazë për shkëmbimin e pikëpamjeve dhe për shfrytëzimin e ekspertizës përkatëse të dy institucioneve për përfitimin e tyre reciprok;
- Që secila palë të mundësojë të angazhohet në shkëmbimin e kapaciteteve teknike dhe profesionale lidhur me çështjet e edukimit profesional si dhe ekspertizën përkatëse.
- Për përmirësimin e ekspertizës si të stafit të SHKÇAK ashtu edhe të BMP-së, përmirësimin e aftësive për zbatimin praktik të SNA-së në angazhimet e auditimit përmes shkëmbimit të përvojave, shkëmbimit të njohurive ndërmjet SHKÇAK dhe BMP për kryerjen e angazhimeve të auditimit dhe harmonizimin e profesionit të auditimit;
- Për shkëmbimin e informatave që synojnë përmirësimin e kapaciteteve të stafit të punësuar nga SHKÇAK dhe BMP për kryerjen e inspektimeve të kontrollit të cilësisë së auditimeve dhe sigurimin e zbatimit të duhur të Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit dhe standardeve të tjera ndërkombëtare, dispozitave kornizë, deklaratave praktike dhe Kodit të Etikës të nxjerrë nga IFAC nga firmat e auditimit dhe auditorët; dhe
- Për zhvillimin e një procesi për thellimin e njohurive për raportet e transparencës përmes analizës së të dhënave dhe sjelljes së përvojave dhe ekspertizave të BE-së në Republikën e Kosovës dhe në Republikën e Shqipërisë.

REZULTATET

Palët e këtij Memorandumi do të bëjnë përpjekjet e tyre maksimale për të arritur rezultatet e mëposhtme:

- b) Projektet e përbashkëta në lidhje me programet e reja arsimore të profesionit dhe programet e zhvillimit të vazhdueshëm profesional në fushën e auditimit;
- c) Promovimi i modelit të bashkëpunimit të tyre dhe rezultateve të tij në institucionet rajonale dhe globale; dhe
- d) Kontributet e të dyja palëve për të përmirësuar cilësinë, saktësinë dhe besueshmërinë e profesionit të auditimit nëpërmjet rregullimit të auditimit dhe mbikëqyrjes së auditorëve.

KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e Memorandumit nuk është e kufizuar dhe hyn në fuqi nga data e nënshkrimit.

NDËRPRERJA

Secila palë mund të tërhiqet nga Memorandumi në çdo kohë pas njoftimit me shkrim të Palës tjetër.

TË TJERA

Palët mund të konsultohen dhe të rishikojnë kushtet e kësaj marrëveshje në rast të një ndryshimi thelbësor në ligje ose rregullore dhe/ose praktika që ndikojnë në zbatimin e këtij Memorandumi, ose nëse dëshirojnë të modifikojnë kushtet e bashkëpunimit të tyre.


DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Ky Memorandum hyn në fuqi nga data e nënshkrimit nga të dyja Palët.

NËNSHKRUAR sot, më datë 23/03/2022, në Prishtinë.

Bordi i Mbikëqyrjes Publike

Dritan FINO
Kryetar



**Shoqata e Kontabilistëve të
Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës**

Shpresa MUSTAFA
Kryetare

